# DËSHMI ARKIVI

**A-471309**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe... |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/berisha-foltoret-e-riperteritjes-ne-vlore-dhe-elbasan-deshmuan-se-ortek-i106174` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 11:46:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 11:36:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0e7945233fbdc74b9eda3d4e7395e4057d30b3584545609b6e9e2a65f197b9d4` |
| TEKSTI | `0fc26110a7487f5ff88571f7952e0af0d8c249488b7febd11720ac963d00c826` |
| PAMJA | `50f5c5f8ebd56b973d0f1913c41a05b81f52c771a880d6b08a2f17ceec0b071e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c0f63c39002cc6e2c12c7c6357bb8fd11d4299f3cb9c98225442c756d5da5be4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c0f63c39002cc6e2c12c7c6357bb8fd11d4299f3cb9c98225442c756d5da5be4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuan se orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe...

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 13:36



Sali Berisha ka zhvilluar një komunikim me qytetarët, ku ka komentuar zhvillimet e fundit politike dhe aktivitetet e Partisë Demokratike në Vlorë dhe Elbasan.

Berisha tha se "Foltoret e Ripërtëritjes" të zhvilluara në këto dy qytete dëshmuan, sipas tij, rritjen e opozitës dhe angazhimin e strukturave të PD-së.

"Orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe do të përmbushë misionin e tij", deklaroi Berisha, duke falënderuar qytetarët, strukturat e partisë dhe deputetët që morën pjesë në këto aktivitete.

Ai u ndal edhe te protestat rinore qytetare, të cilat, sipas tij, kanë vijuar pa ndërprerje. Berisha tha se i përshëndet protestuesit dhe vlerësoi angazhimin e tyre.

Gjatë komunikimit, Berisha komentoi edhe zhvillimet e kësaj jave në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, duke e cilësuar atë si "javën e turpit të Shqipërisë në OKB" dhe duke kritikuar përmbajtjen e fjalimit të kryeministrit.

***Sali Berisha:** Së dyti, këtë javë ishte java e turpit të Shqipërisë në OKB, ku përfaqësuesi i narkoshtetit bëhet kreu i parë i një narkoqeverie që i kushton fjalimin e tij algoritmit dhe asnjë problemi tjetër, pra halleve të veta, dhe dëshmoi se fantazma e algoritmit e ka ngërthyer atë shpirt dhe zemër dhe nuk i ndahet më.*
*Por zhvillimi pozitiv i kësaj jave ishin dy foltoret e Ripërtëritjes të organizuar nga PD në Vlorë dhe Elbasan me një pjesëmarrje të shkëlqyer, me një angazhim të madh të strukturave të partisë, deputetëve, me debate të hapura dhe pyetje të shumta, çka dëshmojnë se procesi i ripërtëritjes së partisë është një imperativë, e cila po ecën dhe do ecë në emër të ripërtëritjes së Shqipërisë.*

*Me këtë rast unë falënderoj përzemërsisht të gjithë qytetarët dhe qytetaret e Vlorës dhe Elbasanit që morën pjesë në këto foltore.*
*Falënderoj degët dhe kryetarët e tyre, zonjën Meçorapaj dhe zotin Tarazani për organizimin.*
*Falënderoj udhëheqësit politikë të këtyre degëve zotin Bylykashi dhe zotin Tomor Alizoti.*
*Falënderoj deputetët e tyre.*
*Ishin aktivitete vërtet të shkëlqyera, të cilat dëshmojnë se orteku i opozitës po rritet çdo ditë dhe do të përmbushë misionin e tij.*
*Ndërkohë protesta rinore qytetare ka vazhduar pa ndërprerë.*
*E përshëndes përzemërsisht dhe i përgëzoj sepse faktikisht po zvarrisin Edi Ramën çdo natë në rrugët dhe bulevardet e Tiranës, moralisht sigurisht.*
*Por, në fakt ai është drejt kohërave të fundit të tij.*

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 26 Shtator12:41

**Berisha kritikon ashpër fjalimin e Ramës në OKB: Përfaqësimi më i turpshëm në histori, nuk përmendi as Kosovën e UÇK-në**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka lëshuar akuza të forta ndaj Kryeministrit Edi Rama lidhur me fjalimin e tij të mbajtur n&...

POLITIKE 26 Shtator12:29

**“U emërua në atë post jashtë çdo kriteri”, Berisha për skandalin e SHISH-it: Vlora Hyseni është kthyer për t’u dhënë reston bashkëpunëtorëve që e tradhtuan**

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, gjatë një bashkëbisedimi me qytetarët në rrjetet sociale, e ka cilësuar jav&e...

POLITIKE 25 Shtator22:40

**Sulmi me vezë ndaj Ramës në Nju Jork jehonë edhe në mediat e mëdha greke**

Tensionet u ndezën gjatë mbërritjes së Edi Ramës në Asamblenë e 81-të të Përgjithshme të OKB-së, nd&...

POLITIKE 25 Shtator22:38

**“Prania besnike e Edi Ramës dhe Erion Braçes”/ Aktivistja përplaset me deputetin: Qeverisë tuaj duhet t’i vijë turp që ka guxim të dalë përballë qytetarëve**

Një përplasje verbale është shënuar ditën e sotme mes akivistes Arvina Lleshi dhe deputetit socialist Erion Braçe...

POLITIKE 25 Shtator22:10

**“Rama do ngelet vetëm e do përfundojë keq”/ Aktivisti Lika: SPAK do godasë Ballukun dhe Ballën, ky pushtet do shembet**

Aktivisti Edison Lika, foli për protestat qytetare kundër qeverisë dhe aktualitetin politik. Lika u shpreh se Rama do ngelet vetëm në ...

POLITIKE 25 Shtator21:22

**Si e komenton Brukseli, skandalin me Vlora Hysenin?**

Komisioni Europian është pyetur për skandalin që ka përfshirë SHISH dhe masën “arrest shtëpie” ndaj Vlora Hy...

POLITIKE 25 Shtator20:58

**“Balluku me akuza, Vlora Hyseni nën arrest”, Ish-kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë: Dosja të tëra në hetim për lidhjet e krimit me pushtetin. Ç’duhet të ndodhë tjetër?**

Zhvillimet e fundit në vend kanë sjellë një reagim nga ish-kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë, Enio Jaço, i cili ndal...

POLITIKE 25 Shtator20:23

**Protesta e 118-të/ Arben Kola: Kryeministri qëndron në dhomë 15 mijë dollarë nata, ndërsa spitalet janë pa ilaçe**

Aktivisti Arben Kola: Dua të nis me një falënderim për shqiptarët e Amerikës dhe një prej koordinatorëve që që...

POLITIKE 25 Shtator20:18

**Protestuesit dhe studentët sfidojnë shiun! Mbyllen fjalimet te Kryeministria, nis marshimi në rrugët e Tiranës**

Protestuesit dhe studentët kanë sfiduar reshjet e shiut mbrëmjen e sotme, duke vijuar tubimin kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Ram...

POLITIKE 25 Shtator20:13

**Aktivisti thirrje Eric Wendt: Na jepni një dorë, duam të krijojmë një qeveri të fortë**

Nga protesta e 118-të kundër qeverisë, aktivisti Erald Ndoj ka zgjedhur t’i drejtohet publikisht ambasadorit të ri të Shteteve t&...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

**“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...**

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

SHOWBIZ 25 Shtator

**"Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...**

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u p&eum...

AKTUALITET 25 Shtator

**“Pse më sheh?”/ Reperi nga Tropoja goditi me th...**

“Pse me shell?” / Reperi nga Tropoja goditi me th...

Zbulohen detaje nga konflikti me armë zjarri që ndodhi mesditën e sotme në Tiranë, në zonën e “Zogut të Zi” ...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

## Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**





**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.